



**PRISIG SH.A.**

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare për vitin që  
ka përfunduar më 31 Dhjetor  
2015**

## RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

### Për menaxhmentin dhe aksionarët e Kompanisë Prisig Sh.a.

Ne kemi qenë të angazhuar për auditimin e pasqyrave financiare shoqëruese të kompanisë së sigurimeve 'Prisig Sh.a.' (më tej referuar si "Kompania"), që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2015, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2015, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

#### *Përgjegjësia e menaxhmentit për Pasqyrat Financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare që janë të lira nga materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura të kontabilitetit dhe bërjen e vlerësimeve të kontabilitetit që janë të arsyeshme për rrethanat.

#### *Përgjegjësia e auditorit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në kryerjen e auditimit. Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe planifikojmë e kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë të lira nga ndonjë gabim material.

Auditimi përfshinë procedurat e kryerjes për të marrë dëshmi të auditimit lidhur me vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen në gjykimin e auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga ndonjë mashtrim ose gabim. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të riskut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të Kompanisë në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga Menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmitë e auditimit që ne kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin tonë të auditimit.



## Opinion

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të Kompanisë paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2015 dhe performancën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

## Çështje tjera

Siç është prezantuar në Pasqyrën e Ndryshimeve në Ekuitet për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2015 ekuiteti i Kompanisë është 2,882,118 Euro. Në bazë të rregullores mbi depozitimin e aseteve si garanci, mjaftueshmërisë së kapitalit, raportimit financiar, menaxhimin e riskut, investimeve dhe likuiditetit Siguruesit janë të obliguar që gjatë gjithë aktivitetit sigurues të mirëmbajnë nivelin minimal të ekuitetit, jo më pak se shumica e kapitalit themeltar prej 3 milionë Euro. Në rast se gjatë aktivitetit sigurues, siguruesit nuk arrijnë të mirëmbajnë nivelin e kërkuar minimal të ekuitetit, atëherë aksionarët e Siguruesit janë të obliguar që të shtojnë kapital shtesë në mënyrë që të mbulojnë mungesat e kapitalit dhe të sjellin Kompaninë në nivelin e kërkuar të ekuitetit. Me 29 Shkurt 2016 aksionari i siguruesit ka deponuar kapital shtesë prej 600,000 Euro dhe brenda afatit ligjor ka plotësuar kërkesat e BQK-së për nivelin minimal të ekuitetit.

**Raportet tjera për kërkesat e autoritetit mbikëqyrës, Bankës Qendrore të Kosovës, për Margjinën e Solvencës dhe Asetet që Konsiderohet për të Mbuluar Obligimet e Sigurimeve .**

Në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK"), neve kemi lexuar Pasqyrat Plotësuese të bashkangjitura për Margjinën e Solvencës dhe Asetet që Konsiderohet për të Mbuluar Obligimet e Sigurimeve ("Pasqyrat Plotësuese"). Këto Pasqyrat Plotësuese të përgatitura nga ana e Menaxhmentit nuk janë pjesë e pasqyrave financiare shoqëruese. Informacione historike financiare të paraqitura në tabelat shtese përgatitur nga menaxhmenti, janë në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me informacionin vjetor financiar shpalosura në pasqyrat financiare shoqëruese të Kompanisë më 31 Dhjetor 2015, të përgatitura në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të aplikueshme për kompanitë e sigurimeve në Kosovë.

Menaxhmenti është përgjegjës për të përgatitur Pasqyrat Plotësuese në pajtim me Rregulloren e BQK-së të datës 30 Prill 2015, mbi depozitimin e aseteve si garanci, mjaftueshmërisë së kapitali, raportimit financiar, menaxhimin e riskut, investimeve dhe likuiditetit


*BDO KOSOVA L.L.C.*

|   | Shënim  | Më 31 Dhjetor 2015<br>(në Euro) |
|---|---------|---------------------------------|
| <b>ASETET</b>   |         |                                 |
| Paraja në dorë dhe në bankë                                       | 6       | 983,777                         |
| Investimet në depozita  | 7       | 3,070,826                       |
| Kosto të shtyra të blerjes  | 8       | 364,935                         |
| Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimet                             | 9       | 44,198                          |
| Asetet e tjera  | 10      | 112,259                         |
| Prona dhe pajisjet  | 11      | 197,260                         |
| Asetet e paprekshme   | 12      | 17,149                          |
| <b>GJITHSEJ ASETET</b>  |         | <b>4,790,404</b>                |
| <b>DETYRIMET</b>  |         |                                 |
| Humbjet dhe shpenzimet e korigjimit të humbjes (rezervat teknike) | 13      | 278,196                         |
| Primet e pa fituara   | 14,14.1 | 1,318,881                       |
| Llogaritë e pagueshme te sigurimeve                               | 15      | 282,756                         |
| Detyrimet tjera   | 16      | 28,452                          |
| <b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>   |         | <b>1,908,285</b>                |
| <b>KAPITALI AKSIONAR</b>  |         |                                 |
| Kapitali aksionar   | 17      | 3,500,000                       |
| Humbja e vitit  |         | (617,881)                       |
| <b>GJITHSEJ KAPITALI AKSIONAR</b>                                 |         | <b>2,882,119</b>                |
| <b>GJITHSEJ DETYRIMET DHE KAPITALI</b>                            |         | <b>4,790,404</b>                |

Autorizuar nga menaxhmenti për botim dhe nënshkruar më 11 Mars 2016.

  
Besarb Blakaj  
Drejtor i Përgjithshëm



  
Blerim Azemi  
Drejtor Financiar

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 27 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.